


Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove

01 Nr./Br. 413/01-14804
Data/Datum 03.07.2020
Gjakovë-Djakovica-Gjakova



KOMUNA E GJAKOVËS

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

I lidhur me dt.09 /07/2020, ndërmjet:

1. Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve (Voice of Roma, Ashkali and Egyptians) si Organizate Joqeveritare me numër të regjistrimit **5113364-1** pranë Ministrisë së Administratës Publike, me adresë në rrugën Milosa Obilica në Graçanicë, 10500 Prishtinë, të cilën e përfaqëson Drejtori Ekzekutiv Isak Skenderi, në tekstin vijues VORAE;
2. Komunës së Gjakovës të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës Ardian Gjini, në tekstin vijues Komuna;

1. Qëllimi i Marrëveshjes

Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe banimit të grupeve të marginalizuara me fokus tek romët, ashkalitë dhe egjiptianët dhe përmirësimi i situatës së tyre sociale në Komunën e Gjakovës.

Kjo ndërhyrje bazohet në Strategjinë Kombëtare për Përfshirjen e Romëve dhe Ashkalive 2017-2021, Planin Lokal i Veprimit të Komunës së Gjakovës dhe mbështetet me Projektin për Përfshirjen Sociale RAESI II të zbatuar nga Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptasve në bashkëpunim me Fondacionin Zviceran HEKS dhe Fondacionin Zviceran Terre des hommes dhe financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) në Prishtinë.

2. Kushtet e përgjithshme

Komuna e Gjakovës ka për qëllim qasjen në përmirësimin e kushteve të banimit të ndertuara nga vet banorët dhe të projektuar dhe testuara në konsultime të ngushta me VoRAE dhe partnerët zviceranë nga HEKS dhe SDC dhe përshtatura për rrethanat dhe nevojat e Kosovës.

Parimi themelorë është të sigurohet se familjet janë të lidhura me sistemet publike të ujit dhe kanalizimeve dhe që ata të kenë qasje në hapësirë adekuate të jetesës dhe banjo funksionale me ujë të ngrohtë.

Projekti parasheh këto modele për ndërtimin:

- a) MODELI 4: Ndërtimin e banjos funksionale dhe riparimin e shtëpisë.
- b) MODELI 3: Riparime të shtëpisë ekzistuese ose ndërtimi i aneks hapësire banimit me banjo funksionale deri në 27 m².
- c) MODELI 2: Riparime të shtëpisë ekzistuese ose ndërtimi i aneks hapësire banimit me banjo funksionale deri në 41 m².
- d) MODELI 1: Shtëpi me banjo funksionale prej 60 m².

Ndërsa Komuna e Gjakoves do të sigurojë të gjitha materialet e ndërtimit që kërkohen për të përfunduar ndërhyrjen bazuar në modelet e lartpërmendura, familja është e obliguar të kryejë të gjitha punimet e ndërtimit, përveç instalimit të ujit dhe energjisë elektrike, të cilat do të sigurohen nga grupet e pjestareve të komuniteteve që mirren me instalim.

Për të siguruar që cilësia minimale e ndërhyrjes zbatohet, Komuna do të monitorojë, duke udhëzuar dhe këshilluar familjet gjatë fazave të ndërtimit.

Buxheti i paraparë për përmirësimin i kushteve të jetesës dhe banimit të grupeve të marginalizuara me fokus tek romët, ashkalitë dhe egjiptianët dhe përmirësimi i situatës së tyre sociale në Komunën e Gjakovës në bazë të kësaj marrëveshje është 40,000.00 €, nga i cili:

Komuna e Gjakovës do të ndajë 20.000.00 €, dhe

VORAE do të ndajë 20.000.00 €.

Mjetet financiare të përmendura më lart, VoRAE do të transferojë në xhirollogarinë e Komunes së Gjakoves me nr. **1000650050000077** në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, me adresë Rr. Garibaldi nr.33, 10.000 Prishtinë.

Bartja e mjeteve prej nga VoRAE në llogarinë e Komunes së Gjakoves do të bëhet si në vijim:

- Kësti i parë në shumën prej 33% nga totali i kontraktuar nga VoRAE tek Komuna e Gjakoves bëhet pas nënshkrimit të marrëveshjes.
- Kësti i dytë në shumën prej 33% nga totali i kontraktuar VoRAE tek Komuna e Gjakoves bëhet pasi që Komuna e Gjakoves do të dorëzojë raportin progresiv të punimeve në terren tek VoRAE duke arsyetuar kështu shpenzimet e kështit të parë.
- Kësti i tretë në shumën prej 34 % nga totali i kontraktuar do të bëhet pasi që Komuna e Gjakoves së bashku me përfaqësues të VoRAE-së do të dorëzojë raportin e inspektimit final duke arsyetuar kështu shpenzimet e kështit të dytë dhe se projekti është finalizuar.

3. Veprimet konkrete të Komunës së Gjakovës

- Pas nënshkrimit të marrëveshjes Kryetari i Komunës së Gjakovës do të përcaktojë Departamentin Përgjegjës me të cilin VoRAE do të ketë bashkëpunim të ngushtë.
- Komuna e Gjakovës duhet të publikojë shpalljen për aplikim të familjeve që kanë nevojë për ndërhyrjen e projektit.
- Do të autorizohet komisioni deri në 3 persona nga Kryetari i Komunës së Gjakovës, të cilët do të jenë të pranishëm në procesin e vizitave në familje dhe selektimin e tyre.

- Komuna e Gjakoves si implementuese do t'ia komunikojë VoRAE-se vendimet dhe aktivitetet e kryera në Komunën e Gjakovës, dhe në rast nevojë do të kërkojë nga organet komunale të ndihmojnë në procesin e vendim-marrjes.
- Komuna e Gjakoves do të kordinoj secilin aktivitet të implementuar në fushën përkatëse të projektit me departamentet përgjegjës të autorizuar nga Kryetari i Komunës.
- Komuna e Gjakoves do të bëjë përzgjedhjen e kompanive për furnizim me material ndërtimorë me komision të përbashkët me pjesëtarët e VoRAE-se .
- Komuna e Gjakoves gjatë tërë procesit të ndërtimit do të monitorojë punimet tek familjet përfituese dhe në përfundim të punimeve ndërtimore është e obliguar të dorëzojë tek VoRAE dosjen me dokumentet të cilat arsyetojnë tërë procesin implementues si dhe kopjet e e shpenzimeve në vlerë prej 20.000.00 €.
- Komuna e Gjakoves do te mundesoj qe instalimin e ujesjellesit,rrymes dhe kanlizmit te realizohen nga pjestaret e komuniteteve rom,ashkali dhe egjiptian.

4.Veprimet konkrete te VORAE

- VoRAE do te ofroj mbeshtetje profesionale gjate procesit te selektimit te familjeve duke ofruar mbeshtetjen teknike dhe metodologjin e punes te cilen e ka praktikuar nga viti 2012 deri ne vitin 2019.
- VoRAE do te ofroj zgjidhjet ideore dhe arkitektonike te modeleve te cilat jane te planifikuara te implementohen.
- VoRAE do te ofrojne Paramasen dhe Parallogarine te specifikuar per materialin e nevojshem ndertimor per implementim te projektit.
- VoRAE do ti ofroj te gjitha format e punes te cilat i ka perdorur gjate viteve te kaluara.

5.Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit dhe është valide deri në përfundim të punimeve në ndërtimin e shtëpive, por jo më gjatë se deri në 31 Dhjetor 2020.

6.Kushtet e Veçanta

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është e plotfuqishme që nga 2020 deri në Dhjetor, 2020.

Kjo marrëveshje është bërë në dy kopje origjinale për secilën palë nga një formë.

Në rast se kjo marrëveshje nuk respektohet atëherë palët janë të obliguara të njoftojnë palën tjetër 30 ditë më herët për shpëputjen e marrëveshjes.

PALËT

Komuna e Gjakovës

Ardian Gjini



VORAE

Isak Skenderi